

LIGJ
Nr.7753, datë 30.9.1993

**PËR MIRATIMIN ME DISA NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.600 DATË 22.7.1993 "PËR
PENGUN DHE HIPOTEKËN"**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të miratohet dekreti nr.600 datë 22.7.1993 "Për pengun dhe hipotekën" me këto ndryshime:

Neni 2, rrjeshti i fundit paragrafi i parë, formulohet si vijon:

"Kreditorët mund të jenë persona fizikë e juridikë, vendas a të huaj".

Neni 11, rrjeshti i parë i paragrafit të dytë formulohet si vijon:

"Kontrata duhet të jetë me shkrim dhe nenshkrimet e data duhet të vërtetohen nga një noter publik".

Neni 18, paragrafi i parë, formulohet si vijon: "Një kontratë që krijon një hipotekë, duhet të vërtetohet nga një noter publik".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.